



MARINGLEN KURTAJ

***Nga “doktori i vogël” te zëri i
drejtësisë***

Në shtëpi, me humor dhe krenari, e quanin *“doktori i vogël”*, një nofkë që i jepte një identitet të hershëm, një ndjenjë përgjegjësie. Por siç ndodh shpesh me ëndrrat fëmijërore, realiteti sjell nuanca të reja. Përmes këshillimit të karrierës dhe reflektimeve personale, ai kuptoi se ndihma njerëzore nuk kufizohej vetëm te trajtimi fizik. Gradualisht, zbuloi se forca e tij nuk qëndronte në stetoskop, por në fjalën e argumentuar, në përballjen me padrejtësitë dhe në aftësinë për të mbrojtur të drejtën. Kështu, u zhvendos nga mjekësia drejt drejtësisë, nga shërimi i trupit, te mbrojtja e dinjitetit.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



HELVETAS



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Momenti i kthesës nuk erdhi nga ndonjë leksion i teorisë juridike, por nga një përvojë shumë konkrete. Si Kryesenator në gjimnaz, ai u përball me një problem real: mungesa e vulës institucionale që rrezikonte vlefshmërinë e diplomave. Për shumëkënd, mund të ishte një çështje burokratike. Për të, ishte momenti ku kuptoi se ligji nuk ishte thjesht një tekst, por një mekanizëm që mbronte të ardhmen.

Këshillimi i karrierës i dha më shumë se një drejtim. I dha vizion. *“Këshillimi i karrierës më ndihmoi të projektoj veten, jo thjesht si një profesionist të diplomuar, por si një individ në rritje të vazhdueshme, që ndërton vlerë sociale. Në horizontin e dhjetë viteve, e shoh veten si një kontribues aktiv në hartimin dhe zbatimin e politikave publike, si një edukator i brezave të rinj dhe si një qytetar që angazhohet për të fuqizuar themelet demokratike të shoqërisë sonë”.*

Nuk munguan momentet e pasigurisë. Ai e përjetoi zgjedhjen jo si një akt të menjëhershëm, por si një proces të kujdesshëm ndërtimi. “Gjatë rrugëtimit tim akademik dhe formues, pati çaste ku rrugët e shumta më krijonin dilema”, tregon Marigleni.

“Në shumë raste, sistemet tradicionale të orientimit priren të favorizojnë *“sigurinë”* mbi pasionin, duke inkurajuar zgjedhje të cilat duken pragmatike, por jo gjithmonë autentike. Une, megjithatë, preferova të ndjek një rrugë që, ndonëse më e vështirë, më lejon të jem plotësisht vetvetja: një profesionist që beson se shërbimi ndaj komunitetit është më shumë sesa një detyrë, është një përkushtim i përditshëm”.

Dhe nuk ishte vetëm drejtësia që e befasoj me thellësinë e saj. Edhe pedagogjia, një fushë që nuk e kishte konsideruar kurrë seriozisht, i dha një kënaqësi të veçantë. Si Asistent-Lektor, kuptoi sa e fuqishme është ndjesia kur je pjesë e formimit të dikujt tjetër.

Marigleni sot ka një mesazh të thjeshtë, por të fuqishëm: dituria nuk është një barrë, por një pasuri që nuk shterohet. Dhe çdo përpjekje e sinqertë është një hap drejt madhësisë.

Sot, ai nuk ka më dyshime. Është i qetë, por jo i ngopur; i përmbushur, por jo i ndalur. Dyshimet e dikurshme janë zëvendësuar nga vendosmëria për të përmirësuar veten dhe realitetin përreth. Është rruga e drejtësisë ajo që ka zgjedhur, jo si thjesht profesion, por si mision.

